

Në përgjigje të email tuaj datë 01.09.2025, po ju sqarojmë si më poshtë:

- Sa është numri i fotografive që datojnë para vitit 1900 në fondin tuaj?

Numri i fotografive që datojnë para vitit 1900 është rreth 160 foto.

- A dispononi statistika të veçanta për këtë periudhë ([p.sh.](#), fotografi të fotografëve të veçantë, qytete, ngjarje specifike etj.)?

Fotografitë janë sistemuar sipas fushave të veprimtarisë; në jetë politike, kulturore, social-ekonomike, fetare, në fotografi qytetesh, fshatrash, fotografi personalitetesh etj. Fondi i fototekës në Arkivin Qendror Shtetëror është i digjitalizuar. Çdo kush mund të hyj në faqen tonë online fototeka.arkiva.gov.al për të parë fototografitë. Blerja e tyre bëhet në ambjentet e institucionit.

- A ekziston një databazë që identifikon veprat (dokumente, foto etj.) që janë në domenin publik/nuk mbrohen nga të drejtat e autorit? Nese po, a është e aksesueshme kjo databazë për studiuesit?

Arkiva është e hapur për çdo qytetarë apo studiues vendas dhe të huaj. Salla e Studimit është e hapur nga e marta në të premte, ora 09:00-19:00 dhe ditën e shtunë nga ora 09:00-14:00. Për sa i përket dokumenteve të digjitalizuara, aktualisht materialet janë të aksesueshme edhe në distancë përmes platformës sonë online.

Lidhur me kërkesën për të studiuar, sqarojmë se kërkimi për dokumentacion bëhet përmes adresës, katalogu.arkiva.gov.al

Fillimisht duhet të plotësohet formularin e regjistrimit dhe brenda 1 ditë pune bëhet pranimi i kërkesës si studiues. Në adresën e e-mail vjen fjalëkalimi që përdoret më pas për tu loguar në sistem. Dosjet e interesuara për ti studiuar duhet të bëhen porosi për ti parë në Sallën e Studimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave Tiranë, në Këndet Arkivore (sipas listës që shfaqen në katalog) ose online përmes aplikacionit "Salla Online"-në shtëpinë tuaj. Për 1 datë të caktuar, që e për zgjedh vetë çdo person, bëhen porosi deri në 20 dosje.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.